



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 128 dt.22.09.1995

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.22.09.1995, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike “Për transferimin kapital të zyrave të Ndërmarrjes së Montimeve Industriale Tiranë”, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.153, dt.03.04.1993 “Për kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të Ndërmarrjeve dhe Institucioneve Shtetërore”.

VENDOSI

1. Të miratojë kërkesën e Ministrisë së Punës dhe Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale për kalimin kapital të ndërtesës së administratës së Ndërmarrjes së Montimeve Industriale në vartësi të dyfishtë midis Bashkisë së Tiranës dhe fondacionit për punësim dhe formim profesional.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Publike në Bashkinë e Tiranës.

KRYETARI

BESNIK PETRELA